



Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University	
Pranuarja e:	01. 12. 2023
Numri i:	011/2611

MEMORANDUM I BASHKËPUNIMIT

NDËRMJET

UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA", GJILAN

DHE

NPL STACIONI AUTOBUSËVE GJILAN SH.A.

Universiteti Publik "Kadri Zeka", me adresë: Rruga Zija Shemsiu, pn. Gjiilan 60000, Republika e Kosovës, përfaqësuar nga Rektori i Universitetit Prof. Asoc. Dr. Artan Dermaku, në vijim i cilësuar si "UKZ" dhe në anën tjetër Ndërmarrja publike lokale **NPL STACIONI AUTOBUSEVE GJILAN SH.A.**, në pronësi të KK Gjiilan, adresa Idriz Seferi p.n., 60000, Gjiilan e përfaqësuar nga Burhan Isufi, UD Kryeshf Ekzekutiv, hynë në Marrëveshje Bashkëpunimi sipas kushteve të mëposhtme:

Neni 1 Qëllimi

1. Ky Memorandum i Bashkëpunimit ka për qëllim përcaktimin e fushave të bashkëpunimit, kushteve, në bazë të të cilave Univerziteti publik "Kadri Zeka" dhe NPL Stacioni Autobuseve Gjiilan Sh.A., pajtohen ti realizojnë.



Neni 2 Fushat e bashkëpunimit

1. Realizimi i punës praktike të studentëve të Universitetit publik “Kadri Zeka”, varësisht për cilët studentë të fakulteteve përkatëse i përshtatet. Kushtet e pranimit të studentëve për praktikë në NPLSA do të vendosen bashkarisht nga dy palët.
2. Shkëmbimi i informacioneve dhe të dhënave jo të kufizuara që kanë për qëllim zbatimin e memorandumit.
4. Studentet sipas kërkesave dhe nevojave të NPLSA do të përgadisnin planin dhe specifikimin për digjitalizimin sipas nevojave të NPLSA.
5. Në bashkëpunim me stafin akademik do të propozojnë edhe databaza dhe programime që nevojiten për digjitalizimin e NPLSA

Neni 3 Kushtet e zbatimit të memorandumit

1. Palët do të sigurojnë që bashkëpunimi do të realizohet në përputhje me këtë Memorandum.
2. Asnjë nga palët nuk angazhohet për detyra specifike, përveç atyre të specifikuara në këtë Memorandum.
3. Asnjë nga palët nuk është e ngarkuar me detyrime financiare ndaj zbatimit të aktiviteteve të përbashkëta siç specifikohet me Memorandumin. **Çdo detyrim financiar që mund të lindë për zbatimin e memorandumit, duhet të rregullohet dhe aprovohet paraprakisht nga palët në formë të shkruar.**
4. Për të siguruar një komunikim të vazhdueshëm për zbatimin e Memorandumit, secila nga palët do të caktojë nga një person kontaktues.
5. Në rast të publikimeve të materialeve promovuese, përmbajtjet e tyre duhet të konfirmohen nga të dyja palët para publikimit të tyre, me qëllim të shmangies së publikimit të ndonjë promocioni/informate pa dijeninë e palëve nënshkruese.



Universiteti	Public University
Pranuar	01.12.2023
Nr. s. T. / E. / L.	011.2611



Neni 4
Interpretimi dhe ndryshimi i memorandumit

1. Ky Memorandum i Bashkëpunimit është përpiluar në 2 (dy) kopje origjinale, një për secilën palë.
2. Interpretimi i këtij Memorandumi do të bëhet në pajtim me Ligjet e Kosovës, duke e ruajtur parimin e reciprocitetit.
3. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Memorandumi mund të bëhen vetëm me shkrim dhe të nënshkruara nga të dyja palët.

Neni 5
Hyrja në fuqi

1. Ky Memorandum i Bashkëpunimit hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga dy palët.

PALËT NËNSHKRUESE

Universiteti Publik "Kadri Zeka"
Prof. Asoc. Dr. Artan Dermaku
Rektor



NPL Stacioni Autobuseve
Z. Burhan Isufi
UD Kryeshef Ekzekutiv

Data: 01.12. 2023